# DËSHMI ARKIVI

**A-442296**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | 161 mijë $ për nënë Filen dhe djalin, gazetari: "Brandon Forever 22 Legacy" bëri vetëm mobilimin dhe pagoi trajtimin |
| ADRESA | `https://versus.al/aktualitet/161-mije-per-nene-filen-dhe-djalin-gazetari-brandon-forever-22-legacy-i46521` |
| BURIMI | versus.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 14 shtator 2026, 08:09:36 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 14 shtator 2026, 07:18:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `206405f8b44fc095c721779d0745a8e045697704005b043fba4f12dab2d058a0` |
| TEKSTI | `f15eaf3b87a09a1dd08cb94126ee527c9424e9f129a31a6728c1ee2a2d199b05` |
| PAMJA | `62110c8802c8324ce72e5376e4ed2fe8b12abd22e4e37457335cca5afca40d23` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `f6ada02b7a4d3f541201d2c916647abf8acc789705bf087d391f448d30ee7c6e` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `ac1c8d986ca8a5982bff13c00b3f40fb9a36fbd6d516390a812a54ba861f1b0b` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/f6ada02b7a4d3f541201d2c916647abf8acc789705bf087d391f448d30ee7c6e`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



AKTUALITET

[Mes kamerave inteligjente dhe programit 'Pas shkolle', sot 25 mijë nxënës ulen për herë të parë në bankat e shkollës]

14 Shtator 2026, 07:50

^ekstrakti^




- Politikë
- aktualitet
- MAGAZInë
- bota
- opinion



- VIDEO



Created and monetized by


AKTUALITET / 14 Shtator 2026, 09:18

# 161 mijë $ për nënë Filen dhe djalin, gazetari: "Brandon Forever 22 Legacy" bëri vetëm mobilimin dhe pagoi trajtimin

Osman Stafa tha se shoqata që grumbulloi ndihmat për nënë Filen dhe djalin e saj ka bërë vetëm mobilimin e banesës dhe ka paguar një kontratë për trajtimin e djalit autik, trajtim që vijon prej 2 muajsh me nga 1200 euro në muaj.

Shkruar nga Versus



Gazetari Osman Stafa publikoi një video lidhur me rastin e "GoFund me" të hapur për zonjën File Bulku dhe djalin e saj me autizëm, pasi nuk është bërë transparencë me shumën prej 161 mijë dollarësh.

Stafa tha se shoqata Brandon Forever 22 Legacy e themeluar nga Manjola Kuqi e cila ndërmori nismën në platformën "GoFund Me" dhe menaxhon paratë e mbledhura nga shqiptarët, ka bërë vetëm mobilimin e shtëpisë, ndërsa rikonstruksioni është bërë me shpenzimet e një kompanie private që nuk dëshiron të përmendet.

Më tej gazetari theksoi se është lidhur edhe një kontratë me shoqatën "Lumturo Dhimbjen" për trajtimin e Andit i cili vuan nga çrregullimi i spektrit të autizmit duke sqaruar se pagesa mujore për këtë trajtim është 1200 euro. Në këtë situatë, gazetari shtron pyetjen për destinacionin e parave të tjera të mbledhura dhe kërkon nga shoqata transparencë totale dhe publikimin e faturave.

*"Shtëpia është e rikonstruktuar nga një kompani private që nuk kërkon të bëhet publike emri i saj dhe nga paratë që janë hedhur nga shqiptarët, kompania nuk ka marrë asnjë qindarkë, pra e ka bërë vetë. Ajo çfarë ka bërë shoqata Brandon Forever 22 Legacy është mobilimi i shtëpisë. Pra kostot e mobilimit ata i kanë marrë nga shqiptarët për të përballuar këtë nevojë. Pra rikonstruksioni bëhet nga një kompani private që nuk merr para nga paratë e mbledhura të shqiptarëve dhe mobilimi bëhet me paratë e shqiptarëve. Nevoja e dytë e nënë Files ka qenë trajtimi që duhet të bëjë Andi me autizëm i cili gjatë gjithë jetës nuk ka marrë asnjë trajtim. Shoqata Brandon Forever ka lidhur një marrëveshje me një qendër që ofron trajtime për autizmin, qëndra 'Lumturo Dhimbjen". Në bazë të marrëveshjes, paguhen në muaj 1200 euro. Shuma e mbledhur nga Shqiptarët është në total 161 mijë dollarë. Shuma e cila ka shkuar tek llogaria bankare e Brandon shkon në 155 mijë dollarë, e konvertuar në lekë është 123 milionë lekë, pra nuk janë euro. Qendra Brandon forever ka detyrim publik të bëjë të ditur se çfarë ndodh me 123 milionë lekë duke bërë publike faturat për mobilimin, sa para parashikohet të marrë trajtimi dhe çfarë ndodh me pjesën tjetër të parave, pra se si e merr shumën tjetër nënë Filja. Duhet bërë transparencë totale se ku shkojnë paratë e shqiptarëve"*- tha Stafa.

Sa i takon videos së publikuar nga shoqata me zonjën File Bulku, gazetari tha se duhet vetëm të ketë transparencë të plotë pasi shqiptarët nuk bazohen më tek fjalët.

*"Nuk e kuptoj se përse kjo qendër nuk publikon faturat, kostot e mobilimit të shtëpisë dhe kostot mujore që duhen paguar për trajtimin e djalit. Kjo është forma më e mirë e transparencës, të tjerat pastaj janë fjalë, nuk binden shqiptarët duke thënë se ne po i ndihmojmë"*- shtoi ai. **Versus.al**

Tags:

brandon forever 22 legacy

Poll



AKTUALITET

[Dita e parë e shkollës shkakton trafik, Tirana zgjohet 'e paralizuar' në rrugët kryesore]

14 Shtator 2026, 08:46

^ekstrakti^



AKTUALITET

[Doli me leje nga burgu, Alket Rizai shkakton kaos në Athinë! Dy të plagosur në lokal pas sherrit për muzikën]

14 Shtator 2026, 08:28

^ekstrakti^




AKTUALITET

[Goditi ish-vjehrrin me çekiç, shpallet në kërkim daja i Zegjine Çaushit në Roskovec]

14 Shtator 2026, 08:10

^ekstrakti^



AKTUALITET

[Mes kamerave inteligjente dhe programit 'Pas shkolle', sot 25 mijë nxënës ulen për herë të parë në bankat e shkollës]

14 Shtator 2026, 07:50

^ekstrakti^





AKTUALITET

[Pse “Çunat e Londrës” kanë nisur të stepen në investimin e parave të drogës në Shqipëri?]

13 Shtator 2026, 21:50

^ekstrakti^




AKTUALITET

[Dita 106 e revoltës ndaj qeverisë, nga nesër ndryshon orari i protestës]

13 Shtator 2026, 20:06

^ekstrakti^



AKTUALITET

["Nuk e di se kush janë hasmit e babait tim", djali i Franc Konomit që u v*a në 2010-ën: Dua të kem mbiemrin e tij]

13 Shtator 2026, 18:53

^ekstrakti^



AKTUALITET

[U siguroi shqiptarëve 20 apartamente për t'i kthyer në 'shtëpi bari', dënohet drejtori i agjencisë imobilare]

13 Shtator 2026, 16:32

^ekstrakti^

[Të fundit]





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.